

# Statistikat e transportit\*

## Gusht 2022

**Tiranë, më 27 Shtator 2022:** Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 161,7 tonë në muajin Gusht 2022, duke u rritur me 4,9 %, në krahasim me Gusht 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Gusht 2022 është 256,2 mijë tonë, duke u ulur me 40,5 %, krahasuar me Gusht 2021.

Në muajin Gusht 2022, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.588 mijë tonë-kilometër, duke u ulur me 3,9 %, krahasuar me Gusht 2021.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër**

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Gusht 2021	430.362	1.652	154,1
Gusht 2022	256.200	1.588	161,7
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-40,5</b>	<b>-3,9</b>	<b>4,9</b>
Janar-Gusht 2021	3.241.125	18.289	1.291,0
Janar-Gusht 2022	2.670.256	13.278	1.294,9
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-17,6</b>	<b>-27,4</b>	<b>0,3</b>

\* Përfshin mallrat dhe postën

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

## Në tetëmuajorin e vitit 2022:

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.294,9 tonë, duke u rritur me 0,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.670,3 mijë tonë, duke u ulur me 17,6 %, krahasuar me tetëmuajorin e vitit 2021.

Volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 13.278 mijë tonë-kilometër, duke u ulur me 27,4 %, krahasuar me tetëmuajorin e vitit 2021.

**Për publikim 27/09/2022**

**Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Gusht 2021	20	4.106	22.688
Gusht 2022	19	4.726	28.509
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-5,0</b>	<b>15,1</b>	<b>25,7</b>
Janar-Gusht 2021	20	15.784	75.998
Janar-Gusht 2022	19	25.830	143.639
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-5,0</b>	<b>63,6</b>	<b>89,0</b>

\*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Numri i fluturimeve në Gusht 2022 u rrit me 15,1 %, krahasuar me muajin Gusht 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Gusht 2022 është 692.805 pasagjerë, duke u rritur me 22,9 %, krahasuar me Gusht 2021.

Në Gusht 2022, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 440.626 pasagjerë. Krahasuar me Gusht 2021, ky tregues është rritur me 43,2 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 425 pasagjerë. Krahasuar me Gusht 2021, ky tregues është ulur me 95,2 %.

Në muajin Gusht 2022, transporti ajror i pasagjerëve zë 61,1 % të transportit gjithsej.

**Në tetëmuajorin e vitit 2022:**

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 3.405.723 pasagjerë, duke u rritur me 95,2 %, krahasuar me tetëmuajorin e vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë detare 1.004.667 pasagjerë, duke u rritur me 59,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë hekurudhore është 9.821 pasagjerë, duke u ulur me 52,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Gusht 2021	8.832	307.634	563.579
Gusht 2022	425	440.626	692.805
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-95,2</b>	<b>43,2</b>	<b>22,9</b>
Janar-Gusht 2021	20.452	631.447	1.744.465
Janar-Gusht 2022	9.821	1.004.667	3.405.723
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-52,0</b>	<b>59,1</b>	<b>95,2</b>

**Burimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

**Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit**

Në Gusht 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 762,0 mijë tonë ku 58,6 % e tyre u transportua me det.

Në tetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 5.933,4 mijë tonë ku 54,4 % e tyre u transportua me det.

**Eksportet e mallrave**

Në Gusht 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 51,3 %, me det 48,4 %, me hekurudhë 0,2 % dhe 0,1 % janë eksportuar me ajër.

Volumi i mallrave të eksportuara me det është rritur 10,4 % ndërsa është ulur volumi i mallrave eksportuar me tokë me 29,9 % dhe me ajër me 3,8 %, krahasuar me Gusht 2021.

**Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit**


Periudha	Eksport (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Gusht 2021	131.509	0	219.634	25	45
Gusht 2022	145.165	720	153.986	24	47
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>10,4</b>	<b>0,0</b>	<b>-29,9</b>	<b>-3,8</b>	<b>4,8</b>
Janar-Gusht 2021	1.135.568	961	1.693.170	113	980
Janar-Gusht 2022	1.208.726	1.824	1.440.886	162	470
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>6,4</b>	<b>89,8</b>	<b>-14,9</b>	<b>42,5</b>	<b>-52,0</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

Në tetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të eksportuara me tokë zë 54,3 % dhe me det 45,6 % dhe 0,1 % me hekurudhë.

Volumi i mallrave të eksportuara me të tre mënyrat e transportit (det, hekurudhë, ajër) ka pësuar rritje, krahasuar me periudhën Janar-Gusht 2021, respektivisht, me det është rritur 6,4 %, me hekurudhë 89,8 %, me ajër 42,5 %, ndërsa është ulur me tokë me 14,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë referuese.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2022**



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

**Importet e mallrave**

Në Gusht 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 65,3 % dhe me tokë 33,4 % dhe të tjera 1,3 %.

Volumi i mallrave të importuara me tokë në Gusht 2022 është ulur me 10,1 % krahasuar me Gusht 2021.


**Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit**

Periudha	Import (ton)				
	Me det	Me hekurudhë	Me tokë	Me ajër	Të tjera
Gusht 2021	302.556	553	171.777	253	4.169
Gusht 2022	301.766	0	154.464	102	5.768
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-0,3</b>	<b>0,0</b>	<b>-10,1</b>	<b>-59,8</b>	<b>38,3</b>
Janar-Gusht 2021	2.167.542	29.740	1.341.178	1.034	18.500
Janar-Gusht 2022	2.020.935	2.780	1.230.873	818	25.877
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-6,8</b>	<b>-90,7</b>	<b>-8,2</b>	<b>-20,9</b>	<b>39,9</b>

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

Në tetëmujorin e vitit 2022, volumi i mallrave të importuara me det zë 61,6 %, me tokë 37,5 %, me hekurudhë 0,1% dhe të tjera 0,8 %. Volumi i mallrave të importuara me tokë është ulur me 8,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

**Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2022**



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT*

# Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transporti tokësor:** Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet:** Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet:** Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007):** Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi, Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>*